



## KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

### KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

#### RELACION

#### **PËR PROJEKTVENDIMIN “RREGULLAT E VEPRIMTARISË SË POLICISË SË SHTETIT NË SHËRBIM TË ZGJEDHJEVE”**

Në përmbushje të kompetencës së parashikuar në nenin 20, paragrafi 1, germa “a” dhe “b”, të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisionit Rregullator i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi “Për rregullat e veprimtarisë së Policisë së Shtetit në shërbim të zgjedhjeve”.

Policia e Shtetit ka një rol të rëndësishëm dhe kryen detyra të rëndësishme të veçantë gjatë fushatës zgjedhore, ditën e zgjedhjeve, gjatë numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve, duke garantuar organizimin dhe administrimin e qetë të procesit zgjedhor, rendin dhe zhvillimin e qetë të votimit ditën e zgjedhjeve. Policia e Shtetit gjatë ushtrimit të veprimtarisë në shërbim të zgjedhjeve, në përmbushje të detyrave të përcaktuara, bashkëpunon me administratën zgjedhore, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor.

Ndryshimet e Kodit Zgjedhor me Ligjin 101/2020, kanë shtuar detyrat dhe përgjegjësitë për Policinë e Shtetit gjatë veprimtarisë në shërbim të zgjedhjeve. Në vlerësim të rëndësishme të detyrave të Policisë së Shtetit në shërbim të zgjedhjeve, detyrave të reja të përcaktuara në nenin 3 paragrafi 8, neni 34 paragrafi “h”, neni 79 paragrafi 5, nenin 109, paragrafi 6 dhe 7, si edhe të detyrave të ushtruara nga Policia e Shtetit në zgjedhjet pararendëse, të përcaktuara në nenin 109, paragrafi 3, nenin 110, paragrafi 2, nenin 114, paragrafi 2 dhe 3, nenin 115, paragrafi 7, nenin 121, paragrafi 2, projektvendimi përcakton rregulla dhe detajon rolin dhe përgjegjësitë e Policisë së Shtetit dhe të administratës zgjedhore gjatë veprimtarisë së tyre në shërbim të zgjedhjeve.

Neni 1, neni 2, dhe neni 3, reflektojnë qëllimin dhe objektin e vendimit, përkufizime të termave, dhe parime të përgjithshme sipas përcaktimeve të nenit 3, të Kodit Zgjedhor, dhe nenit 5 të Ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

Neni 4, një transpozim korrekt i nenit 5 të Kodit Zgjedhor, parashikon ndalimin e përdorimit gjatë gjithë fushatës zgjedhore të forcave komando dhe forcave të tjera të ushtrisë dhe strukturave të posaçme, dhe ndalimin e përdorimit të tyre për ruajtjen e objekteve që kanë lidhje me zgjedhjet. Përcaktohet detyrimi për t’i dërguar menjëherë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve kopje e

urdhrit të ministrit që mbulon rendin publik dhe Ministrin të Mbrojtjes për përdorimin e forcave komando dhe forcave të tjera të ushtrisë kur këto forca nevojiten për ruajtjen e objekteve të rëndësishme të veçantë, në zëvendësim të punonjësve të Policisë së Shtetit ose në zbatim të detyrimeve ndërkombëtare.

Neni 5 dhe neni 6, përcaktojnë detyrime për punonjësit e Policisë së Shtetit të ngarkuar me detyra në shërbim të zgjedhjeve, për veshjen, identifikimin, armatimin, vendqëndrimin në periudhën 24 orë para ditës së zgjedhjeve dhe në ditën e zgjedhjeve, duke përcaktuar lejimin e qëndrimit të tyre mjediset e brendshme apo të jashtme të ndërtesave ku kryhet administrim zgjedhor vetëm me kërkesë të Komisionit Zonal të Administrimit Zgjedhor, apo të Komisionit të Qendrës së Votimit. *Dokumenti i identifikimit të punonjësit të Policisë së Shtetit të ngarkuar me detyra zgjedhore, paraqitet në lidhjen 1.*

Neni 7, përcakton rregulla dhe afate për komunikimin ndërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në ushtrim të kompetencës së parashikuar në nenin 19, paragrafi 1, germa “a”, të Kodit Zgjedhor, dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Afati 30 ditë para ditës së zgjedhjeve për dërgimin nga Komisioneri të listës së plotë të objekteve ku janë të vendosura QV-të, KZAZ-të, VNV-të, dhe adresat e sakta të vendndodhjes së tyre, përcaktohet në referim të:

1. përcaktimeve të nenit 62, paragrafi 4, të Kodit Zgjedhor (vendndodhja e QV nuk mund të ndryshojë 40 ditët e fundit para datës së zgjedhjeve )
2. përcaktimeve të nenit 94, paragrafi 1, të Kodit Zgjedhor (jo më vonë se 40 ditë nga data e zgjedhjeve KQZ cakton VNV-të) .

Afati 10 ditë para ditës së zgjedhjeve për paraqitjen nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit të listës së plotë të punonjësve të ngarkuar me detyra gjatë zgjedhjeve, vendvendosjes së punonjësit të Policisë së Shtetit për ruajtjen e QV-ve, KZAZ-ve, VNV-ve, dhe në ditën e votimit, përcaktohet në referim të:

1. përcaktimeve të nenit 99, paragrafi 1, të Kodit Zgjedhor (KQZ dërgon në selitë e KZAZ-ve, jo më vonë se 3 ditë para datës së zgjedhjeve materialet zgjedhore)
2. përcaktimeve të nenit 100, paragrafi 1, të Kodit Zgjedhor (KZAZ, jo më vonë se 15 orë para hapjes së votimit, u shpërndan materialet zgjedhore KQV-ve nën juridiksionin e saj).

Neni 8, një transpozim korrekt i nenit 79 të Kodit Zgjedhor, reflekton rregullimet ligjore për përdorimin dhe afishimin e materialeve propagandistike nga subjektet zgjedhore, dhe ndalimet përkatëse. Në paragrafin 6 të këtij neni përcaktohet e drejta e Komisionerit në ushtrim të kompetencës së parashikuar në nenin 19, paragrafi 1, germa “a”, të Kodit Zgjedhor, për të njoftuar Kryetarin e Bashkisë ose Policinë e Shtetit për shkelje të përcaktimeve të këtij neni.

Neni 9, përcakton detyrimin për Policinë e Shtetit për hartimin e planit të masave në funksion të ushtrimit korrekt të veprimtarisë dhe kryerjes së detyrave në shërbim të zgjedhjeve. Ndër të tjera parashikohet instruktimi dhe trajnimi i punonjësve të Policisë së Shtetit për detyrën e ngarkuar, duke i njohur edhe me dokumentacionin zgjedhor që përdoret nga administrata zgjedhore në rastet kur kërkohet ndihma e Policisë së Shtetit për vendosjen e rendit dhe të rregullit në mjediset ku kryhet administrim zgjedhor.

Neni 10, përcakton rregulla për komunikimin dhe bashkërendimin e masave/veprimeve të Komisionit Zonal të Administrimit Zgjedhor me Policinë e Shtetit, dhe përgjegjësinë e Sekretarit të KZAZ për dokumentimin e rasteve në detaje.

Neni 11, përcakton rregullat për ruajtjen nga Policia e Shtetit të ndërtesave ku kryhet administrim zgjedhor, komunikimin/bashkërendimin midis KZAZ dhe komisariteve të njësisve të vetqeverisjes vendore për këtë qëllim, kohën e ruajtjes nga Policia e Shtetit të QV dhe VNV.

Neni 12, përcakton ndalimin e qëndrimit të personave të armatosur në mjediset e qendrës së votimit, dhe rastet e përjashtimit kur lejohet e punonjësit të Policisë së Shtetit për të hyrë në QV, sipas përcaktimeve të nenit 109 të Kodit Zgjedhor.

Në vështrim të Ligjit 80/2020 “Për Policinë e Burgjeve”, paragrafit 3 të nenit 14, të tij ku përcaktohet se *“Punonjësi i Policisë së Burgjeve ndalohet të përdorë armë brenda regjimit të brendshëm të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, përveçse në situatat emergjente, sipas legjislacionit në fuqi për përdorimin e armëve të zjarrit”*, në këtë nen të rregullave nuk është përfshirë rasti i përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 110 të Kodit Zgjedhor, ku si përjashtim nga rregulli për ndalimin e personave të armatosur në qendrën e votimit, përcaktohet edhe punonjësi i policisë së burgjeve brenda territorit të burgut ose vendit të paraburgimit, ku është ngritur qendra e posaçme e votimit.

detyrimin e njoftimit të KZAZ për orën e njoftimit të punonjësit të Policisë së Shtetit, orën e ndërprerjes së votimit, dhe orën e rifillimit të tij, si dhe detyrimin për të dokumentuar në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KQV-së të gjithë të dhënat në raport me hyrjen/daljen e punonjësit të Policisë së Shtetit nga QV, po ashtu edhe për përshkrimin e incidentit të ndodhur. Në paragrafin 4

të këtij neni parashikohen modelet e vendimeve të KQV-ve për këtë rast, kopje të së cilave do t'i dorëzohen punonjësit të Policisë së Shtetit.

Neni 13, në paragrafët 1, 2, 3 dhe 4 të tij, transponon përcaktimet e paragrafit 6 dhe paragrafit 7 të nenit 109, të Kodit Zgjedhor. Në paragrafët 5 dhe 6 të këtij neni përcaktohen procedurat që do të ndjekë KZAZ-ja për njoftimin e Policisë së Shtetit për rivendosjen e rendit në mjediset jashtë qendrës së votimit.

Neni 14, përcakton detyrat, veprimet dhe përgjegjësitë e punonjësit të Policisë së Shtetit të ngarkuar me detyrën e shoqërimit të kutisë/kutive të votimit dhe kutisë së materialeve të votimit nga QV në KZAZ.

Neni 15, paragrafët nga 1 deri në 8, janë transpozim korrekt i përcaktimeve të nenit 121 të Kodit Zgjedhor, duke plotësuar me detyrimin e KZAZ-së për të njoftuar menjëherë KQZ për incidentin e ndodhur në VNV. Paragrafi 9 i nenit, përcakton ndërhyrjen e menjëhershme të Policisë së Shtetit për raste të krimeve të rënda në qendrën e votimit apo në VNV, me qëllim ndërprerjen e aktivitetit kriminal dhe kapjen e autorëve në kushtet e flagrancës. Për këto raste është parashikuar detyrimi i Policisë së Shtetit për të njoftuar menjëherë KQZ dhe KZAZ.

Neni 16, përcakton përgjegjësinë e Policisë së Shtetit për të garantuar rendin dhe sigurinë në rrethinat e ndërtesave ku ndodhet VNV, si dhe detyrimin për të njoftuar menjëherë Komisionerin për raste të tilla.

Neni 17, përcakton rregulla për lëvizjet/qarkullimin e punonjësve të Policisë së Shtetit të ngarkuar me detyra zgjedhore, vetëm në rastet kur kjo kërkohet nga KZAZ ose nga KQV-ja. Në paragrafin 2 të këtij neni përcaktohet detyrimi i identifikimit të mjetetve të policisë në funksion të zgjedhjeve, të uniformuara apo të pauniformuara, përmes shenjës/tabelës dalluese, sipas modelit 2 bashkelidhur.

Neni 18 parashikon shfuqizimin e Udhëzimi nr. 7, datë 23.03.2009, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për miratimin e detyrave të Policisë së Shtetit dhe Forcave të Ushtrisë në zgjedhje”, i ndryshuar, hyrjen në fuqi të rregullave, dhe detyrimin e publikimit të tyre në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: dhjetor 2020

Nr:

PROJEKTVENDIM

PËR MIRATIMIN E  
RREGULLAVE TË VEPRIMTARISË SË  
POLICISË SË SHËRBIMIT NË SHËRBIM TË ZGJEDHJEVE

Komisioni Rregullator, në mbledhjen e tij të datës .12.2020, me pjesëmarrjen e:

Iirjana	NANO -	Kryetare
Arens	ÇELA -	Anëtar
Dritan	ÇAKA -	Anëtar
Helga	VUKAJ -	Anëtare
Muharrem	ÇAKAJ -	Anëtar

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Miratimin e rregullave të veprimtarisë së Policisë së Shtetit në shërbim të zgjedhjeve.

**BAZA LIGJORE:** Neni 20, paragrafi 1 germa “a” dhe “b”, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Komisioni Rregullator pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, dhe dëgjoi diskutimet e të pranishmëve, në zbatim të kompetencës së parashikuar në nenin 20, paragrafi 1, germa “a” dhe “b” të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

## V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullave të veprimtarisë së Policisë së Shtetit në shërbim të zgjedhjeve, lidhjeve 1, 2, bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

**Ilirjana NANO - Kryetare**

**Arens ÇELA - Anëtar**

**Dritan ÇAKA - Anëtar**

**Helga VUKAJ - Anëtare**

**Muharrem ÇAKAJ - Anëtar**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONI RREGULLATOR**

---

**RREGULLAT E VEPRIMTARISË SË**  
**POLICISË SË SHETIT NË SHËRBIM TË ZGJEDHJEVE**

Neni 1

**Qëllimi dhe objekti**

1. Qëllimi i këtyre rregullave është të organizojë funksionimin e veprimtarisë së Policisë së Shtetit dhe bashkërendimin e punës së saj me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve në shërbim të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, parandalimit, dokumentimit dhe ndjekjes penale në përputhje me ligjin dhe duke respektuar të drejtat e liritë e njeriut dhe në paanshmëri të plotë ndaj subjekteve zgjedhore.
2. Objekti i këtyre rregullave është detajimi i rolit dhe i përgjegjësisë së Policisë së Shtetit dhe i administratës zgjedhore, gjatë veprimtarisë së tyre në drejtim të:
  - a) zbatimit të detyrave në shërbim të administrim
  - b) it të qetë dhe të rregullt të proceseve zgjedhore ose të referendumeve;
  - c) bashkëpunimit me administratën zgjedhore në zgjedhje ose në referendume dhe
  - d) raportimit për veprimtarinë e strukturave të policisë në zgjedhje ose në referendume.

Neni 2

**Përkufizime**

Për këto rregulla termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “**KQV**” është Komisioni i Qendrës së Votimit.
2. “**KQZ**” është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, i cili është organi më i lartë shtetëror i përhershëm, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve, në përputhje me rregullat e përcaktuara në Kodin Zgjedhor.
3. “**KZAZ**” është Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, që ngrihet dhe funksionon në përputhje me Kodin Zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë dhe zgjedhjet vendore.
4. “**Qendër votimi**” është mjedisi i caktuar për zhvillimin e votimit, në përputhje parashikimet e Kodit Zgjedhor.

5. “VNV” është vendi i numërimit të votave, mjedisi i caktuar me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për zhvillimin e procesit të numërimit të votave në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor.
6. “Mjediset jashtë qendrës së votimit” janë hyrja, oborri dhe ambientet perqark oborrit të ndërtesës ku kryhet votimi dhe rreth saj në një rreze prej 150 m nga Qendra e Votimit, i perimetruar me shenja dalluese të qarta për publikun dhe pa cënuar interesin e ligjshëm të pronësisë së të tretëve.
7. “Material propaganduese statike” janë materialet që i shërbejnë subjektit zgjedhor për promovimin e fushatës zgjedhore dhe që janë vendosur ose afishuar në vende ose hapësira publike me akses publik, si shtyllat e ndriçimit të rrugëve, fasadat e ndërtesave, sheshet, pjesët ballore të dyqaneve ose ndërtesave, përgjatë rrugëve të qyteteve, rrugëve ndërqytetëse, etj.
8. “Periudha e angazhimit të policisë në zgjedhje” është kohëzgjatja e angazhimit të policisë në shërbim të zgjedhjeve për përmbushje të detyrave të ngarkuara në Kodin Zgjedhor. Në cdo rast kjo periudhë fillon më së paku katër muaj para datës së zgjedhjeve.

### Neni 3

#### Parime të përgjithshme

1. Policia e Shtetit i ushtron detyrat e veta në shërbim të zgjedhjeve në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor, në paanshmëri të plotë ndaj subjekteve zgjedhore, në përputhje me ligjin 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar si dhe dispozitat e tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit në raport me masat dhe mjetet në përdorim të saj.
2. Policia e Shtetit zhvillon veprimtarinë në shërbim të zgjedhjeve duke u mbështetur në parimet e mëposhtme:
  - a) ligjshmëria;
  - b) mosdiskriminimi;
  - c) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
  - ç) proporcionaliteti;
  - d) pavarësia operationale;
  - dh) paanshmëria politike;
  - e) integriteti, merita dhe profesionalizmi;
  - ë) transparenca;
  - f) ruajtja e informacionit të klasifikuar;
  - g) kontrolli dhe llogaridhënia.

### Neni 4

#### Ndalimi i përdorimit të forcave dhe strukturave të posaçme

1. Ndalohet përdorimi i policisë kriminale dhe forcave të tjera të ushtrisë gjatë gjithë fushatës zgjedhore, përveçse me urdhër me shkrim të ministrit që mbulon rendin publik dhe Ministrin të Mbrojtjes, kur këto forca nevojiten për ruajtjen e objekteve të rëndësishme të veçantë, në zëvendësim të punonjësve të Policisë së Shtetit ose në zbatim të detyrimeve ndërkombëtare. Një kopje e urdhrin me shkrim i dërgohet menjëherë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.



2. Në rastet kur del e domosdoshme aktivizimi i forcave speciale, struktura përgjegjëse duhet të njoftojë me shkrim dhe në kohë reale pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve:
  - a) objektin e punës/lëvizjes;
  - b) kush e ka kërkuar daljen e forcave speciale;
  - c) raportim të veprimeve që janë duke kryer,
  - d) si dhe në fund të kryerjes së detyrës kjo strukturë duhet të hartojë një raport me shkrim për detyrën e kryer.

Në cdo rast njoftimime shkrin në përputhje me parashikimin e kësaj pike duhet të bëhet duke ruajtur sekretin operacional.

3. Ndalohet angazhimi i punonjësve të policisë të rekrutuar në 4 muajt e fundit para ditës së zgjedhjeve.
4. Ndalohet përdorimi i forcave komando dhe i forcave të tjera të ushtrisë për ruajtjen e objekteve që kanë lidhje me zgjedhjet.
5. Ndalohet kryerja e ushtrimeve ose manovrave ushtarake nga forcat e ushtrisë jashtë reparteve ose vendeve të dislokimit të tyre gjatë gjithë fushatës zgjedhore.
6. Ndalohet përdorimi ose pjesëmarrja e punonjësve apo strukturave të Shërbimit Informativ Shtetëror.

#### Neni 5

### **Veshja dhe armatimi i Policisë së Shtetit**

1. Punonjësit e Policisë së Shtetit, të ngarkuar me detyra zgjedhore sipas ligjit 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, gjatë ushtrimit të detyrës janë të detyruar në çdo moment të mbajnë uniformën e Policisë së Shtetit dhe të kenë në një vend të dukshëm numrin rendor të caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe mbiemrin e tyre me përmasa të dukshme, sipas modelit të përcaktuar në Lidhjen 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit përcakton me urdhër të vecantë llojin e armatimit dhe të pajisjeve që do të mbajnë punonjësit e Policisë së Shtetit të ngarkuar me detyra për ruajtjen e QV, KZAZ dhe VNV, gjatë shoqërimit të kutive të votimit me fletët e votimit dhe materialeve të votimit, duke vlerësuar, rast pas rasti, situatën kriminale dhe infomacionet që disponon Policia e Shtetit për ndërtesat ku kryhet administrimi zgjedhor. Kopje e urdherit i dërgohet menjëherë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

#### Neni 6

### **Vendqëndrimi i policisë së shtetit**

1. Punonjësit e Policisë së Shtetit që ngarkohen me detyra gjatë zgjedhjeve, gjate periudhes zgjedhore respektojnë levizjet dhe qendrimin ne vendet e percaktuara ne kete akt dhe aktet e tjera nenligjore te nxjerra nga KQZ.
2. Punonjësit e Policisë së Shtetit mund të lejohen të qëndrojnë në mjediset e QV, KZAZ dhe VNV në rastet kur KQV-ja ose KZAZ-ja ka kërkuar rivendosje të rendit në Qendrën e Votimit, në Vendin e Numërimit të Votave.

3. Punonjësit e Policisë së Shtetit lejohen të qëndrojnë në mjediset jashtë ndërtesës ku kryhet administrimi zgjedhor në rastet kur KQV-ja ose KZAZ-ja ka kërkuar rivendosjen e rendit në mjediset jashtë qendrës së votimit, në oborrin e ndërtesës, në hyrje të saj dhe në korridoret e brendshme apo në rrethinat e ndërtesave ku kryhet administrimi zgjedhor.

#### Neni 7

### **Komunikimi ndërmjet KQZ-së dhe Policisë së Shtetit**

1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i kërkon informacione dhe i parashtron kërkesa Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe sipas rastit Drejtorit/ëve të Drejtorive të Policisë në Qarqe, në rastet kur vlerëson se veprimtaria e punonjësve të Policisë së Shtetit mund të dëmtojë apo të pengojë administrimin ose zhvillimin e zgjedhjeve të lira, të drejta, demokratike dhe transparente. Institucioni përkatës, është i detyruar të paraqesë menjëherë informacion për veprimet e kryera dhe marrjen e masave për zbatimin e ligjit.
2. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i dërgon Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit 30 ditë para ditës së zgjedhjeve listën e plotë të objekteve ku janë të vendosura QV-të, KZAZ-të, VNV-të, dhe adresat e sakta të vendndodhjes së tyre.
3. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit i paraqet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve 10 ditë para datës së zgjedhjeve listën e plotë të punonjësve të ngarkuar me detyra gjatë zgjedhjeve. Ai është i detyruar të informojë menjëherë Komisionerin për çdo ndryshim në listë.
4. Për secilin nga punonjësit e Policisë së Shtetit të përfshirë në listë, duhet të pasqyrohen të dhënat personale, grada që mban, detyrat funksionale, vendvendosja e punonjesit të Policisë së Shtetit për ruajtjen e QV-ve, KZAZ-ve, VNV-ve, dhe në ditën e votimit, emri i eprorit të drejtpërdrejtë, lloji i shërbimit të policisë ku bën pjesë punonjësi, dhe në mënyrë të detajuar rrethi i detyrave të ngarkuara.
5. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit përgjatë periudhës së angazhimit të policisë në zgjedhje, i dorëzon menjëherë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve kopje të urdhërave për angazhimin e punonjësve të Policisë së Shtetit të ngarkuar me detyra zgjedhore si dhe listën e automjeteve që do të përdoren prej tyre gjatë procesit zgjedhor.
6. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit përgjatë periudhës së angazhimit të policisë në zgjedhje i dorëzon menjëherë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve kopje të urdhërave për angazhimin e forcave speciale dhe forcave të ndërhyrjes së shpejtë.

#### Neni 8

### **Regjistri i posacëm i veprave penale**

1. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit mban një regjistër të posacëm për çdo njoftim dhe referim të veprave penale në fushën zgjedhore.
2. Gjatë periudhës zgjedhore, ky regjistër është i aksesueshëm në cdo moment nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe nga subjektet zgjedhore.

#### Neni 9

### **Materialet propagandistike të subjekteve zgjedhore**

1. Jo më vonë se 35 ditë para datës së zgjedhjeve, kryetari i bashkisë, në mënyrë të drejtë dhe të paanshme, përcakton vendet publike në territorin e bashkisë përkatëse për afishimin prej partive politike dhe subjekteve zgjedhore të materialeve propagandistike. Vendet e caktuara duhet të jenë në ambiente që sigurojnë shikueshmëri publike dhe të kenë hapësirë të mjaftueshme ku të gjitha subjektet zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje të paraqesin programet e tyre zgjedhore dhe mesazhet zgjedhore. Vendimi i kryetarit të bashkisë bëhet publik në faqen e internetit të bashkisë menjëherë pas miratimit.
2. Gjatë fushatës zgjedhore përdorimi dhe afishimi i çdo materiali tjetër statik për propagandë zgjedhore, përfshirë flamujt dhe posterat, lejohet vetëm në një largësi prej deri 5 metrash nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës.
3. Të gjitha materialet propagandistike vizive që përdoren në fushatë duhet të shoqërohen me shënimin: “Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të...” (vijon emri i subjektit zgjedhor).
4. Ndalohet përdorimi i materialeve propagandistike që mund të ndodhen në qendrën e votimit dhe rreth saj në një rreze prej 150 m.
5. Ndalohet përdorimi i materialeve propaganduese në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij neni.
6. Policia Bashkiake dhe/ose Policia e Shtetit garantojnë zbatimin e përcaktimeve të bëra në këtë nen duke hequr menjëherë çdo material propagandues të subjekteve zgjedhore në vendet jashtë përcaktimeve të bëra në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.
7. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, kur informohet për shkelje të përcaktimeve të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, njofton Kryetarin e Bashkisë përkatëse, dhe në rast mosveprimi nga Policia Bashkiake, kërkon ndërhyrjen e Policisë së Shtetit.

#### Neni 10

#### **Plani i masave**

1. Policia e Shtetit, para fillimit të ushtrimit të detyrave të saj në shërbim të zgjedhjeve harton Planin e Masave për ruajtjen dhe sigurimin e ndërtesave ku kryhet administrim zgjedhor dhe mjediseve jashtë qendrës së votimit, si dhe shoqërimin e materialeve të votimit, për pajisjen e punonjësve të Policisë së Shtetit të ngarkuar me detyra në shërbim të zgjedhjeve me armatim sipas parashikimit të paragrafit 2 të nenit 5 të kësaj rregulloreje, pajisjet e tjera të nevojshme për shërbim, dhe me dokumentin e identifikimit sipas lidhjes 1 bashkëlidhur.
2. Instrukton dhe trajnon punonjësit e Policisë së Shtetit edhe në lidhje me dokumentacionin zyrtar që përdoret gjatë procesit zgjedhor si:
  - a) kopje të formatit të miratuar nga KQZ për njoftimin e Policisë së Shtetit për ndërhyrje në QV, VNV;
  - b) kopje të formatit të miratuar nga KQZ për largimin e forcave të Policisë së Shtetit nga QV, VNV;
  - c) kopje të formatit të miratuar nga KQZ të proces verbalit të dorëzimit të KZAZ të materialeve të votimit;
  - ç) kopje model procesverbalit të dorëzimit të Qendrës së Votimit;
  - d) kopje model të raporteve të shërbimit.
3. Policia e Shtetit në Planin e Masave parashikon:
  - a) pajisjen e punonjësve të policisë me listën emërore dhe numrat përkatës të telefonit të personave me të cilët duhet të komunikojë gjatë kohës së shërbimit (punonjësve të policisë, drejtuesve të shërbimeve të policisë, kryetarin dhe/ose sekretarin të Komisionit të Qendrës së Votimit, KZAZ).

- b) caktimin e oficerit të policisë përgjegjës për secilin grup shërbimi;
  - c) pajisjen dhe vendosjen në të gjithë mjetet e policisë të uniformuara dhe të pa uniformuara, mbishkrimin sipas lidhjes nr.2 bashkëlidhur;
  - ç) cakton automjetin dhe drejtuesin e tij, në dispozicion të secilit grup shërbimi, që do të shërbejë për dërgimin e punonjësve të Policisë së Shtetit pranë qendrave të votimit.
4. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit informon Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve, për atë që është e mundur, në lidhje me zbatimin e parashikimeve të këtij neni.

#### Neni 11

#### **Komunikimi dhe bashkërendimi i veprimeve të KZAZ-së me Policinë e Shtetit**

1. KZAZ-ja i drejtohet Drejtorit të Policisë Vendore, dhe njofton menjëherë KQZ-në, për probleme që mund të lindin dhe kanë të bëjnë me sjelljen dhe qëndrimin e punonjësve të Policisë së Shtetit gjatë ushtrimit të detyrave në shërbim të zgjedhjeve.
2. Sekretari i KZAZ-së është përgjegjës për:
  - i. bashkërendimin e masave me Policinë e Shtetit për rendin publik në funksion të zgjedhjeve;
  - ii. dokumentimin në detaje në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së, të rasteve të ndërhyrjeve të Policisë së Shtetit në mjediset ku kryhet administrim zgjedhor apo në rrethinat e tyre
  - iii. administrimin e dokumentacionit zyrtar për ndërhyrjet e policisë në rivendosjen e rendit publik, kur jashtë qendrës së votimit rrezikohet rendi ose pengohet procesi i rregullt i votimit.
3. Sekretari i KZAZ-së është përgjegjës për njoftimin e Drejtorit të Policisë Vendore dhe /ose Shefit të Komisionariatit të Policisë që mbulon territorin ku ka vendndodhjen QV, në mjedisin e së cilës është raportuar se rrezikohet rendi ose pengohet procesi i rregullt i votimit. Ky njoftim i bëhet me dije edhe anëtarëve të KZAZ-së.
4. Sekretari i KZAZ-së vë në dijeni menjëherë KQZ-në në të gjitha rastet kur është kërkuar ndërhyrja e punonjësit të Policisë së Shtetit për rivendosjen e rendit, brenda ose jashtë mjedisit dhe/ose ndërtesave ku kryhet administrim zgjedhor.
5. Sekretari i KZAZ-së i dërgon Policisë së Shtetit grafikun e miratuar nga KZAZ-ja për dorëzimin e materialeve zgjedhore tek KQV-të, emrat e Kryetarëve dhe Sekretarëve të KQV-ve dhe numrat e tyre të kontaktit.
6. Në rastet kur evidentohen probleme në VNV, KZAZ-ja, me vendim, njofton menjëherë punonjësit e Policisë së Shtetit dhe rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së, duke përfshirë edhe orën e saktë të ardhjes dhe largimit të punonjësve të Policisë së Shtetit.

#### Neni 12

#### **Ruajtja e ndërtesave ku kryhet administrim zgjedhor**

1. Kryetari i KZAZ-së jo më vonë se shtatë ditë përpara datës së zgjedhjeve, njofton shefin e Komisionariatit të Policisë të njësisë së vetqeverisjes vendore, ku ndodhet zyra e KZAZ-së për vendndodhjen e KZAZ-së dhe orarin e punës. Njoftimi regjistrohet në regjistrin e korrespondës së KZAZ-së.
2. Selia e KZAZ-së ruhet nga punonjësit e Policisë së Shtetit, nga momenti kur në të mbërrijnë materialet zgjedhore deri në datën e zgjedhjeve.

3. Ruajtja e selisë së KZAZ-së nga punonjësit e Policisë së Shtetit bëhet gjatë periudhës që KZAZ-ja nuk është në punë.
4. Shërbimi i ruajtjes sipas paragrafit 2 të këtij neni fillon menjëherë me paraqitjen e kërkesës së kryetarit të KZAZ-së. Kërkesa është me shkrim dhe i dërgohet shefit të Komisarariatit të Policisë që mbulon njësinë e vetqeverisjes vendore, ku është vendosur selia e KZAZ-së. Kërkesa i bëhet me dije Drejtorit të Policisë Vendore.
5. Kur në KZAZ kanë mbërritur materialet zgjedhore, në mjediset e oborrit të ndërtesës ku ndodhet selia e KZAZ-së, në hyrje dhe në korridoret e brendshme të ndërtesës, nuk lejohet prania apo grumbullimi i personave, përveç personave të ngarkuar me detyra për administrimin zgjedhor ose vëzhguesit e akredituar nga KQZ/ KZAZ. Prezenca e personave të tjerë, në mjediset ku kryhet administrimi zgjedhor apo në rrethinat e tyre është shkak për pezullimin e procesit dhe për të kërkuar ndërhyrjen e Policisë së Shtetit për të rivendosur rendin.
6. Policia e Shtetit organizon ruajtjen e qendrave të votimit nga momenti kur në to mbërrijnë materialet zgjedhore deri në momentin kur KQV-ja paraqitet në QV për kryerjen e veprimeve paraprake për çeljen e votimit. Punonjësi i Policisë së Shtetit në përfundim të shërbimit harton një raport shërbimi për periudhën që ai ka shërbyer.
7. Policia e Shtetit organizon ruajtjen e ambjentit të Vendit të Numërimit të Votave prej orës 18<sup>00</sup> të ditës së zgjedhjeve deri në momentin kur KZAZ-ja transporton kutinë/kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit drejt KQZ-së.
8. Punonjësi i Policisë së Shtetit qëndron jashtë ambjenteve të Vendit të Numërimit të Votave, sipas caktimit të bërë nga KZAZ-ja.

#### Neni 13

#### **Lejimi i punonjësit të Policisë së Shtetit për t'u futur në mjedisin e Qendrës së Votimit dhe mjediset jashtë qendrës së votimit**

1. Asnjë person i armatosur nuk lejohet të qëndrojë në mjediset e qendrës së votimit **dhe mjediset jashtë qendrës së votimit**. Përfshihen nga ky rregull punonjësit e Policisë së Shtetit, kur janë në ushtrim të detyrës, në përputhje me paragrafin 2, 3 dhe 4 të këtij neni.
2. KQV-ja njofton organet e Policisë së Shtetit dhe KZAZ-në në rastet kur në qendrën e votimit rrezikohet rendi ose zhvillimi i rregullt i votimit, si dhe plotëson proceverbalin e pezullimit të votimit për këtë qëllim. Në procesverbal shënohet ora e njoftimit dhe pezullimit të votimit. KQV-ja shënon, gjithashtu, në Librin e Protokollit të Mbledhjeve incidentin e ndodhur, orën e ndërprerjes së votimit dhe orën e rifillimit të tij.
3. Kryetari ose çdo anëtar i KQV-së njofton menjëherë KZAZ-në për incidentin e ndodhur. KZAZ-ja është e detyruar të shënojë në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së njoftimin dhe orën e marrjes së tij. KZAZ-ja ia përcjell kërkesën menjëherë organeve të Policisë së Shtetit.
4. Me rivendosjen e rendit në qendrën e votimit, KQV-ja u kërkon organeve të Policisë së Shtetit të largohen nga qendra e votimit dhe merr masa për rifillimin e menjëhershëm të votimit. Ky fakt pasqyrohet në procesverbalin e rifillimit të votimit.
5. Vendimet e KQV-së për kërkimin e ndihmës nga Policia e Shtetit për rivendosjen e rendit në qendrën e votimit dhe për largimin e saj nga qendra e votimit janë sipas modeleve të miratuara me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

#### Neni 14

### **Rendi në mjediset e jashtme të Qendrës së Votimit**

1. Në mjediset jashtë qendrës së votimit, në oborrin e ndërtesës, në hyrje të saj dhe në korridoret e brendshme të ndërtesës dhe rreth QV dhe në një rreze prej 150 m, sipas shenjave dalluese nuk lejohet prania apo grumbullimi i personave, përveç zgjedhësve që presin në radhë për të votuar.
2. Përjashtim nga rregulli i përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, bën prania e vëzhguesve të pajisur me shenjën dalluese dhe përfaqësuesve të medias së autorizuar, si dhe e personave të ngarkuar me kryerjen e sondazheve për votimin, kur organizata që ata përfaqësojnë është autorizuar për këtë qëllim nga KQZ-ja.
3. Intervistimi i votuesve për llogari të sondazheve bëhet në rrethinat e jashtme të ndërtesës, në vend intervistim me shenja të qarta dalluese dhe shpjeguese dhe pa penguar në asnjë rrethanë dhe për asnjë shkak kalueshmërinë dhe hyrje-daljen e lirë të zgjedhësve në qendrën e votimit.
4. Prezenca e personave të tjerë, jashtë parashikimeve të paragrafit 2 dhe paragrafit 3 të këtij neni, në mjediset e jashtme apo në rrethinat e qendrës së votimit, është shkak për pezullimin e procesit dhe për të kërkuar ndërhyrjen e Policisë së Shtetit për të rivendosur rendin.
5. KZAZ me marrjen e njoftimit për situata sipas parashikimeve të paragrafëve 1, 3 dhe 4 të këtij neni, verifikon informacionin dhe njofton menjëherë Policinë e Shtetit për rivendosjen e rendit publik në mjediset e jashtme të QV-së.
6. Sekretari KZAZ-së vepron në përputhje me paragrafin 2 dhe 3 të nenit 10 të këtyre rregullave, si dhe referuar Rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës të Administrimit Zgjedhor.

#### Neni 15

### **Shoqërimi i kutive të votimit dhe materialeve të votimit në VNV**

1. Me mbylljen e votimit kryetari i KQV-së njofton komisariatit e policisë dhe KZAZ-në duke i kërkuar të dërgojë në KQV punonjësin e policisë i cili është i planifikuar me libër shërbimi në ruajtjen e KQV dhe është efektiv i përhershëm i Policisë së Shtetit, përjashtuar policinë kriminale, që do të shoqërojë kutinë/të e votimit dhe kutinë e materialeve të votimit deri në KZAZ/VNV.
2. Punonjësi i Policisë së Shtetit paraqitet në kohën e caktuar nga KQV-ja dhe pret në hyrje të saj, derisa të dalin anëtarët dhe sekretari së bashku me kutinë/të e votimit me fletët e votimit dhe kutinë e materialeve të votimit.
3. Shoqërimi i kutisë/ve të votimit me fletët e votimit dhe i kutisë së materialeve të votimit nga KQV-ja në Vendin e Numërimit të Votave bëhet me automjet në të cilin ndodhen anëtarët e KQV-së, sekretari i KQV-së dhe një punonjës i Policisë së Shtetit.
4. Gjatë shoqërimit, kutia/të e votimit me fletët e votimit dhe materialet e tjera zgjedhore, administrohen vetëm prej Kryetarit, Sekretarit dhe anëtarëve të KQV-së. Punonjësi i Policisë së Shtetit nuk ka të drejtë në asnjë rast, që të posedojë, apo të ketë kontakt, me materialet e mësipërme.
5. Punonjësi i Policisë së Shtetit, i ngarkuar me detyrën e shoqërimit të kutisë/ve të votimit me fletët e votimit dhe kutisë së materialeve të votimit nga Qendra e Votimit në Vendin e Numërimit të Votave, garanton shoqërimin dhe mosprekjen e tyre nga të tretët.

6. Punonjësi i Policisë së Shtetit i ngarkuar me shoqërimin e kutisë/ve të votimit me fletët e votimit, dhe kutive të materialeve të votimit, sipas paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni, harton një raport shërbimi ku pasqyrohet edhe çdo parregullsi e konstatuar (kur ka të tilla) gjatë procesit të shoqërimit nga KQV-ja në Vendin e Numërimit të Votave, si dhe informon njëkohësisht eprorin e tij dhe ky i fundit njofton shefin e Komisarariatit të Policisë dhe KZAZ-në.
7. Pas procesit të dorëzimit të kutisë/ve të votimit me fletët e votimit dhe kutisë së materialeve të votimit në VNV, punonjësi i Policisë së Shtetit firmos bashkë me Kryetarin dhe Sekretarin e KQV-së procesverbalin e marrjes në dorëzim, sipas modelit të miratuar nga KQZ-ja.
8. Punonjësi i Policisë së Shtetit pas marrjes së kopjes të procesverbalit të dorëzimit largohet menjëherë nga VNV. Kopja e procesverbalit të marrjes në dorëzim së bashku me raportin e shërbimit dorëzohet në strukturën eprorë ku ai bën pjesë.

#### Neni 16

#### **Lejimi i punonjësit të Policisë së Shtetit për t'u futur në ambientet e VNV-së**

1. Në Vendin e Numërimit të Votave, gjatë procesit të numërimit të votave, janë të pranishëm vetëm anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së, anëtarët e grupeve të numërimit, kandidatët, vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, vëzhgues të tjerë të akredituar, përfaqësuesit e akredituar të medias, si dhe personeli teknik për mbarëvajtjen e sistemit të kamerave apo pajisjeve të tjera të teknologji/informacion, i autorizuar nga KQZ-ja.
2. KZAZ-ja merr masa dhe është përgjegjëse për moslejimin e personave të tjerë në Vendin e Numërimit të Votave, përveç atyre të parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni.
3. KZAZ-ja, gjatë procesit të numërimit të votave, kur konstaton se në ambientin e VNV-së janë të pranishëm dhe persona të tjerë, përveç atyre të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni, pezullon procesin e numërimit dhe me vendim, njofton menjëherë punonjësit të Policisë së Shtetit dhe rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së, duke përfshirë edhe orën e saktë të ardhjes dhe largimit të punonjësve të Policisë së Shtetit.
4. KZAZ-ja, kur në Vendin e Numërimit të Votave rrezikohet rendi, me vendim njofton menjëherë punonjësit të Policisë së Shtetit dhe rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së, duke përfshirë edhe orën e saktë të ardhjes dhe largimit të punonjësve të Policisë së Shtetit.
5. Me marrjen e vendimit Kryetari, zëvendëskryetari ose çdo anëtar i KZAZ-së thërret menjëherë Policinë dhe njofton KQZ-në për incidentin e ndodhur.
6. Vendimi për kërkimin e ndihmës për vendosjen e rendit i paraqitet me shkrim punonjësve të Policisë së Shtetit dhe përmban përshkrimin e shkurtër të shkaqeve dhe të rrethanave.
7. KZAZ-ja u dorëzon menjëherë punonjësve të policisë së Shtetit që paraqiten në Vendin e Numërimit të Votave, përpara ndërhyrjes, kopje të vendimit për thirrjen e policisë.
8. KZAZ-ja me vendim u kërkon punonjësve të Policisë së Shtetit të largohen, menjëherë sapo rivendoset rendi në Vendin e Numërimit të Votave.
9. Vendimet e KZAZ për kërkimin e ndihmës nga Policia e Shtetit për rivendosjen e rendit në VNV dhe për largimin e saj nga VNV janë sipas modeleve të miratuara me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
10. Për krimet e rënda që mund të ndodhin në Qendrën e Votimit gjatë ditës së votimit apo në Vendin e Numërimit të Votave gjatë numërimit të votave në kushtet e flagrancës, Policia e Shtetit ndërhyr menjëherë për të ndërprerë aktivitetin kriminal dhe për të kapur autorët e

dyshuar. Për veprimet e kryera dhe masat e marra struktura e Policisë së Shtetit njofton menjëherë Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe KZAZ, sipas kërkesave të këtij neni.

#### Neni 17

### **Rendi dhe siguria në ambientet e jashtme të VNV**

1. Policia e Shtetit është përgjegjëse për ruajtjen dhe garantimin e rendit dhe sigurisë në rrethinat e ndërtesave ku ndodhen VNV.
2. Punonjësit e Policisë së Shtetit marrin të gjitha masat për organizimin e shërbimeve të nevojshme policore për menaxhimin e çdo situatë që mund të krijohet në ambientet e jashtme të VNV.
3. Punonjësi i Policisë së Shtetit me detyrë në VNV:
  - a) komunikon menjëherë me drejtuesit e drejtorisë së policisë qarkut duke e informuar në lidhje me situatën e krijuar dhe masat që janë marrë.
  - b) vlerëson në vijimësi situatën dhe në rast nevojë kërkon ndihmë për forca shtesë më të specializuara,
  - c) bashkëpunon me KZAZ dhe drejtuesit e organeve të qeverisjes vendore
  - d) sipas rastit, duhet të bashkëpunojë dhe të koordinojë me organet e prokurorisë së rrethit gjyqësor për kryerjen e veprimeve procedurale.
4. Për situatat e krijuara punonjësi i Policisë së Shtetit me detyrë në VNV dhe KZAZ njofton menjëherë Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve.

#### Neni 18

### **Lëvizjet e policisë**

Qarkullimi i punonjësve të policisë së Shtetit, të ngarkuara me detyra zgjedhore, bëhet vetëm me mjete policie dhe vetëm në rast se kërkohet ndërhyrja e tyre respektivisht nga KQZ-ja, KZAZ-ja ose nga KQV-ja.

#### Neni 19

### **Sanksionet**

Shkelja e rregullave të këtij të parashikuara në ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, të ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar dhe rregullave të këtij akti apo akteve të tjera të miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përgjatë periudhës së parashikuar në paragrafin 8, të nenit 2 të këtij akti, kur nuk përbën vepër penale përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet sipas sanksionit administrativ të parashikuara në paragrafi 1 të nenit 171 të Kodit Zgjedhor.

#### Neni 20

### **Shfuqizime dhe hyrja në fuqi**

1. Udhëzimi nr. 7, datë 23.03. 2009, i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për miratimin e detyrave të Policisë së Shtetit dhe Forcave të Ushtrisë në zgjedhje”, i ndryshuar, shfuqizohet.
2. Këto rregulla hyjnë në fuqi menjëherë dhe publikohen në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONI RREGULLATOR**

**Lidhja 1**

		
<b>REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E BRENDSHME Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit Drejtoria Vendore e Policisë Komisariati i Policisë</b>		
<b>DOKUMENT IDENTIFIKIMI</b>		
_____		
Grada                  Emër                  Mbiemër		
NR. _____		<div style="border: 1px solid black; width: 80px; height: 60px; margin: 0 auto; text-align: center; padding: 5px;">Foto</div> <div style="border: 1px solid black; width: 60px; height: 40px; margin: 0 auto; text-align: center; padding: 5px;">Vula</div>
Punonjës i Policisë së Shtetit, caktuar me shërbim në		
KZAZ/KQV. nr. _____		
ZGJEDHJET PER KUVEND/ORGANET E QEVERISJES VENDORE		
DATE		

Legjenda:



Materiali karton me ngjyrë të bardhë.  
Përmasat 10 x 6 cm.  
Shkrimi ngjyre e zezë.  
Stemat sipas koloreve.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONI RREGULLATOR

Lidhja 2

	<b>KOMISARIATI I POLICISË</b> _____	
<b>AUTOMJET I POLICISË SË SHTETIT I ANGAZHUAR NË SHËRBIM TË ZGJEDHJEVE në datën ____ . ____ . ____</b>		
<b>Shefi i Komisarariatit të Policisë</b> _____	 vula	<b>Targa</b> _____ <b>Nr</b> _____

Legjenda:

Materiali: karton me ngjyrë të bardhë.  
Përmasat: 60x20 cm.  
Shkrimi ngjyrë blu.  
Stemat sipas koloreve.

